



REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK) DHE TË PROKURORIT TË SHTETIT (PSH) PËR VITIN 2020

Titulli: Realizimi i Planit të Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe të Prokurorit të Shtetit (PSh) për vitin 2020

Autore: Albana Hasani

Kontribuoj: Egzona Bexheti

Viti i botimit: Maj 2021

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542



FOL

Të drejtat e autorit © 2021. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

*Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

PËRMBAJTJA

- 1 1. Përmbledhja ekzekutive
- 3 2. Hyrje
- 5 3. Realizimi i planit të punës së KPK-së
- 5 3.1 Fuqizimi i kornizës ligjore dhe strukturës organizative të sistemit prokurorial
- 7 3.2 Llogaridhënia sistematike dhe kontrolli i vazhdueshëm i punës së prokurorëve
- 8 3.3 Fuqizimi i integritetit të prokurorëve
- 9 3.4 Avancimi i sistemit për vlerësimin e performances së prokurorëve
- 10 3.5 Fuqizimi i mëtejme i sistemit të rekrutimit
- 11 3.6 Avancimi i sistemit të disiplinimit
- 12 3.7 Avancimi i sistemit të disiplinimit
- 13 3.8 Avancimi i statusit dhe rolit të stafit administrativ
- 14 3.9 Transparenca dhe komunikimi me publikun dhe mediet
- 15 3.10 Bashkëpunimi me institucionet vendore, i mbështetur në respekt reciprok
- 16 3.11 Bashkëpunimi me partnerë dhe donatorë (bashkëpunimi ndërkombëtar\ bashkëpunimi i jashtëm)
- 17 3.12 Sigurimi i infrastrukturës fizike adekuate
- 18 3.13 Avancimi i teknologjisë informative dhe menaxhimit të të dhënave
- 19 3.14 Avancimi i sistemit të zhvillimit të karrierës (fuqizimi i sistemit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve)
- 20 3.15 Trajtimi i rasteve të bartura
- 21 3.16 Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit

PËRMBAJTJA

- 22 4. Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
- 22 4.1 Fuqizimi i koordinimit, bashkëpunimit, komunikimit dhe llogaridhënies
- 23 4.2 Fuqizimi i planifikimit, sigurimit, menaxhimit dhe shpenzimit të buxhetit sipas nevojave të sistemit prokurorial
- 25 4.3 Sigurimi i shërbimeve, infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të sigurisë në sistemin prokurorial
- 26 4.4 Fuqizimi i burimeve njerëzore në planifikimin dhe zbatim të proceseve të punës
- 27 4.5 Zhvillimi dhe avancimi i teknologjisë informative
- 29 5. Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë
- 29 5.1 Avancimi i proceseve të brendshme të punës
- 30 5.2 Mbështetja e KPK-së dhe PSH-së në administrimin e proceseve të punës dhe shqyrtimin e performancës së prokurorive
- 32 5.3 Analizimi i punës së prokurorëve dhe prokurorive
- 33 5.4 Vlerësimi i aplikimit të sistemeve digjitale dhe rekomandimet përkatëse
- 34 5.5 Mbështetja e ngritjes së kapaciteteve profesionale në sistem prokurorial
- 35 6. Realizimi i planit të punës së prokurorit të shtetit (PSH) 2020
- 35 6.1 Avancimi i punës profesionale të prokurorit të shtetit për hetimin dhe përfaqësimin e rasteve
- 36 6.2 Forcimi i besimit të publikut se prokurori i shtetit është profesional, transparent, llogaridhënës, efikas, efektiv, me integritet dhe i pavarur
- 37 6.3 Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
- 38 6.4 Digjitalizimi dhe modernizimi i punës së prokurorit të shtetit
- 39 6.5 Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe integritetit të prokurorit të shtetit.
- 39 6.6 Rritja e shkallës së sekuestrimit të aseteve të fituara me vepër penale
- 40 7. Rekomandime

AKRONIMET

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

PSh - Prokurori i Shtetit

PTh – Prokuroria Themelore

PSRK -Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

ZKPSH – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

NJSHPP – Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

ZMNV - Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave

SMIL - Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve

SIMBNj - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

SIMFK - Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

SEMDP – Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve

KKLKE - Koordinator Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

BQK – Banka Qendrore e Kosovës

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Plani i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për vitin 2020, duke përfshirë Sekretariatit e KPK-së dhe Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve (NJSHPP), parashihte realizimin e 26 objektivave, ndërsa Plani i Punës së Prokurorit të Shtetit (PSh) për vitin 2020 parashihte realizimin e 6 objektivave.


Në funksion të realizimit të këtyre objektivave, në këto plane të punës ishin paraparë të ndërmerren një varg aktivitete, shumica prej të cilave me afat të përmbylljes deri në dhjetor të vitit 2020.

Ndonëse të përballur me vështirësi e sfida të ndryshme si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19 në mars të vitit 2020, realizimi i aktiviteteve dhe objektivave që këto institucione i kishin caktuar vetes me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe performancës, ishte arritur në mënyrë të konsiderueshme.

Sipas të dhënave të pranuar nga KPK, nga 177 aktivitete sa ishin paraparë të realizohen në Planin e Punës së KPK-së të vitit 2020, KPK kishte arritur të përmbush 143 prej tyre, ndërsa 34 aktivitete të tjera nuk kishin arritur të finalizoheshin brenda kohës së paraparë në këtë plan.

Niveli i përmbushjes së Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020 në tërësi (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK) PËR VITIN 2020



Grafikoni 1. Niveli i përmbushjes së Planit të Punës së Këshillit Prokurorial të vitit 2020.


Rëndësi e posaçme në përpilimin e objektivave të Planit të Punës së KPK-së i ishte kushtuar llogaridhënies, kontrollit dhe fuqizimit të integritetit të prokurorëve, avancimit të sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve, avancimit të sistemit teknologjik, trajtimit të rasteve të bartura, bashkëpunimit me institucione vendore dhe me partnerë ndërkombëtar, si dhe transparencës dhe komunikimit me publikun dhe mediat. Gjithashtu, rëndësi e veçantë në këtë plan i ishte kushtuar trajtimit me prioritet të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Ndërkaq përmbushja e Planit të Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2020 ishte planifikuar të bëhet përmes disa mekanizmave/veprimeve, për të cilat nuk ishte paraparë ndonjë afat i përmbylljes. Këto objektiva përfshinin avancimin e punës profesionale të Prokurorit të Shtetit për hetimin dhe përfaqësimin e rasteve, forcimin e besimit të publikut tek Institucioni i PSh-së, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, digjitalizimin e punës së PSh-së, rritjen e sekuestrimit të aseteve të fituara me vepër penale, si dhe forcimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së punës së prokurorëve.

Sipas PSh-së, realizimi i këtyre objektivave ishte paraparë të bëhet përmes 32 aktiviteteve, 31 prej të cilave kishin arritur të realizohen në tërësi, edhe përkundër vështirësive të shkaktuara nga përhapja e pandemisë COVID-19.

Niveli i përmbushjes së këtij plani në tërësi (bazuar në të dhënat e pranuar nga PSh) është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË PROKURORIT TË SHETIT (PSh) PËR VITIN 2020



Grafikoni 2. Niveli i përmbushjes së Planit të Punës së Prokurorit të Shtetit të vitit 2020.

Sipas PSh-së, ndër sfidat kryesore me të cilat është përballur ky institucion në përmbushjen e këtij plani të punës ishin:

- organizimi i punës dhe resurseve njerëzore për ballafaqim me pandeminë COVID-19,
- zbatimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL),
- numri i madh i lëndëve të ndryshme penale dhe atyre me kryerës të panjohur (PPN, PPP) të trashëguara nga vitet paraprake,
- fuqizimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe stafit në profile specifike etj.

Sa i përket publikimit të aktiviteteve të realizuara të këtyre planeve në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, gjatë hulumtimit në këtë ueb-faqe, nga 143 aktivitete të realizuara të Planit të Punës së KPK-ës, ne kemi arritur të gjejmë të dhëna për publikimin e vetëm 18 aktiviteteve.

Ndërkaq nga të gjitha aktivitetet e realizuara të Planit të Punës së PSh-së për vitin 2020 (31 aktivitete), ne kemi arritur të gjejmë të dhëna për publikimin e vetëm 2 aktiviteteve.

2.HYRJE

Duke marrë parasysh rëndësinë dhe peshën e madhe të përgjegjësisë së bartësve të institucioneve të sistemit prokurorial, monitorimi dhe analizimi i punës së këtyre institucioneve në aspekt të efikasitetit dhe rezultateve të arritura, është i rëndësishëm së veçantë. Në këtë drejtim, me qëllim të zbatimit të projektit “Sektori i drejtësisë në Kosovë, i përgjegjshëm, i besueshëm dhe transparent”, dhe me mbështetjen e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL), Lëvizja FOL ka analizuar nivelin e realizimit të Planit të Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe të Prokurorit të Shtetit (PSh) për vitin 2020.

Përmes këtij raporti synohet krijimi i një pasqyre të përgjithshme në lidhje me nivelin e përmbushjes së objektivave dhe aktiviteteve të parapara në këto plane të punës. Lidhur me këtë duhet përmendur konstatimet e dalura në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2020, ku ndër të tjera thuhet se në përgjithësi këto dokumente përcaktojnë vetëm objektivat e përgjithshme dhe duhet të shoqërohen nga plane të detajuara vjetore të veprimit për arritjen e këtyre objektivave.¹ Në këtë raport gjithashtu ceket nevoja e një strategjie gjithëpërfshirëse për sektorin e sundimit të ligjit e cila do të kontribuonte në forcimin e pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, si dhe kapacitetit të përgjithshëm të gjyqësorit dhe prokurorisë.

¹ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2020, Komisioni Evropian.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, si institucion i pavarur, me mandat edhe përgjegjësi të rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me Ligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ka për detyrë kushtetuese dhe ligjore që të siguroi qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Republikën e Kosovës. Ndërkaq, me qëllim të zbatimit të Planit Strategjik 2019 – 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës çdo vit harton plane vjetore të punës. Në Planin Vjetor të Punës së KPK-së për vitin 2020² janë paraparë objektivat kryesore dhe aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive. Rrjedhimisht, mund të konkludojmë se objektivat institucionale të cilat Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) i kishte vënë vetes në këtë plan shtrihen në drejtim të fuqizimit të kornizës ligjore që rregullon fushëveprimtarinë e saj institucionale, ngritjen e llogaridhënies, transparencës dhe komunikimit me publikun dhe mediet, fuqizimin e integritetit institucional, avancimin e sistemit të performancës, trajtimin e lëndëve të bartura nga periodha e kaluar, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit institucional etj.

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, Prokurorit i Shtetit është institucion i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera që përcaktohen me ligj. Në Planin e Punës për vitin 2020³, Prokurori i Shtetit kishte paraparë realizimin e 6 objektivave specifike, si dhe një varg aktiviteteve dhe mekanizmash për arritjen e këtyre objektivave. Kësisoj, si prioritet ka përcaktuar avancimin e punës profesionale të PSh-së, fuqizimin e besimit të publikut ndaj PSh-së si institucion profesional, transparent, llogaridhënës, digjitalizimin dhe modernizimin e punës, forcimin e paanshmërisë dhe integritetit, si dhe rritjen e shkallës së aseteve të fituara me vepër penale etj.

Të dhënat që përmban ky raport hulumtues si burim e kanë ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Kosovës, ku përfshihen të dhënat e KPK-së dhe të PSh-së. Gjithashtu, me qëllim të matjes së saktë të përmbushjes së objektivave dhe realizimit të aktiviteteve nga këto plane të punës, Lëvizja FOL ka hartuar një pyetësor në lidhje me nivelin e realizimit të secilës objektive të paraqitur në këto plane. Në këtë mënyrë, nga përgjigjet dhe të dhënat e pranuar, FOL ka bërë përmbledhjen strukturore të të dhënave, analizimin në drejtim të arritjes së përmbushjes në kohën e paraparë, si dhe llogaritjen e rezultateve duke u bazuar në indikatorët matës. Po ashtu, raporti përmban të dhëna në lidhje me nivelin e publikimit të aktiviteteve të realizuara në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial.

² <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/PLANI%20I%20PUN%C3%8BS%20KP K%202020%20-%20SHQIP.pdf>

³ <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/PLANI%20I%20PUN%C3%8BS%20I%20PROKURORIT%20T%C3%8B%20SHKETIT%20-%202020.pdf>

Duke u nisur nga premisa se ky raport mëton që të shpërfaq në formë statistikore nivelin e përmbushjes së planeve vjetore të punës, duhet bërë e qartë se në këtë raport nuk synohet matja e cilësisë së objektivave dhe aktiviteteve të përmbushura nga këto plane, apo efektshmëria e tyre, por analizohet vetëm aspekti kuantitativ i përmbushjes së këtyre planeve.

3. REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË KPK-SË

Plani i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) i vitit 2020, duke përfshirë Sekretariatën e Këshillit Prokurorial dhe Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHPP), parashihte realizimin e 26 objektivave. Secila prej këtyre objektivave parashihte arritjen e qëllimeve specifike në drejtim të fuqizimit të sistemit prokurorial në përgjithësi, në pajtim me misionin dhe vizionin e këtij institucioni.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave, ky plan parashihte ndërmarrjen e një numri të madh të aktiviteteve, për të cilat ishte përcaktuar afati kohor i përmbylljes.

Në vijim të këtij raporti janë shtjelluar të dhënat në lidhje me nivelin e realizimit të aktiviteteve të secilës objektivë të këtij plani, si dhe se sa prej aktiviteteve të realizuara janë publikuar në ueb-faqen e Sistemit Prokurorial.

3.1 FUQIZIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË SISTEMIT PROKURORIAL

Në kuadër të objektivës së parë të KPK-së, ishte paraparë realizimi i 14 aktiviteteve, shumica prej të cilave me afat të përmbylljes deri në dhjetor të vitit 2020. Prej tyre, KPK kishte realizuar vetëm 6 aktivitete, ndërsa 8 aktivitetet të tjera nuk ishin finalizuar ende.

Sipas përgjigjes së KPK-së, aktivitetet e përfunduara të kësaj objektivë ishin:

- Hartimi i platformës për procesin e rishikimit funksional të sektorit të drejtësisë;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullores për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Hartimi i Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
- Hartimi i udhëzimit për angazhimin e interpretëve dhe përkthyesve;
- Hartimi i rregullores për zhvillimin profesional të prokurorëve dhe stafit administrativ.


Ndërkaq aktivitetet që nuk kishin arritur të realizohen tërësisht ishin:

- Miratimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit;
- Hartimi i Rregullores së NJSHPP-në,
- Hartimi i Rregullores për dosje të prokurorëve;
- Rishikimi i Rregullores për SKPKnë;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve;
- Themelimi i mekanizmit për hartim të rekomandimeve për legjislacion;
- Hartimi i Rregullores për administrimin dhe ndarjen e lëndëve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave;
- Hartimi i Strategjisë për trajtimin me prioritet të korrupsionit dhe krimit ekonomik 2020 -2022.

Sipas informatave të pranura nga KPK, situata e krijuar me pandeminë COVID-19 ka bërë që të shtyhen iniciativat për ndryshime legjislative sa i përket transferimit dhe avancimit të prokurorëve, si dhe kanë pamundësuar realizimin e aktiviteteve të tjera të kësaj objektive.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, kemi gjetur të dhëna në lidhje me 4 aktivitete të realizuara nga kjo objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 3. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së parë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.2 LLOGARIDHËNIA SISTEMATIKE DHE KONTROLI I VAZHDUESHËM I PUNËS SË PROKURORËVE

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 5 aktiviteteve dhe atë me afat të përmbylljes deri në dhjetor të vitit 2020. Prej këtyre aktiviteteve, KPK kishte realizuar 4 aktivitete, ndërsa vetëm 1 aktivitet as nuk kishte filluar.

Sipas informatave të pranura nga ana e KPK-së, aktivitetet e realizuara ishin:


- Vlerësimi dhe hartimi i analizës në funksion të llogaridhënies;
- Përcaktimi i sistemit të ri të mbikëqyrjes së punës së prokurorive dhe prokurorëve;
- Raportimi i Kryeprokurorëve të prokurorive;
- Raportimi i kryeprokurorëve dhe prokurorive si dhe raportimet e komisioneve të përhershme dhe ad-hoc.

Ndërsa aktiviteti që nuk kishte arritur të realizohet ende ishte:

- Krijimi i mekanizmit për vlerësimin e hudhjes së kallëzimeve penale për veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe krimeve ekonomike.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nga kjo objektivë kemi gjetur të dhëna të publikuara vetëm për 1 aktivitet të realizuar.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 4. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së dytë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.3 FUQIZIMI I INTEGRITETIT TË PROKURORËVE

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 3 aktiviteteve, të cilat sipas përgjigjes së KPK-së, ishin përmbushur në tërësi nga ana e këtij institucioni.

Aktivitetet e parapara në këtë objektivë ishin:

- Vlerësimi i sistemit aktual për verifikimin e integritetit të prokurorëve;
- Forcimi i mekanizmit të kontrollit të prokurorëve dhe stafit administrativ;
- Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies.

Sipas të dhënave të pranura nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, KPK në vazhdimësi ka kontribuar në procesin e rishikimit funksional të sundimit të ligjit si dhe ne grupin punues lidhur me “Modalitetet e llogaridhënies me përfshirjen e Vettingut në sistemin e drejtësisë në Kosovë”, duke dërguar komente dhe ofruar informata të cilat janë përfshirë në këto dokumente e që kanë të bëjnë me llogaridhënien dhe integritetin.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 5. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së tretë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.4 AVANCIMI I SISTEMIT PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCES SË PROKURORËVE

Objektiva e katërt e KPK-së përfshinë implementimin e 4 aktiviteteve, të cilat po ashtu ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së.

Këto aktivitete përfshinin:

- Rishikimin e kriterëve të vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe hartimin e rekomandimeve për ndryshimet ligjore të nevojshme;
- Hartimi i koncept-dokumentit për sistemin e vlerësimit të prokurorëve, hartimin e analizave për proceset e vlerësimit të performancës së prokurorëve;
- Hartimi i analizave për proceset e vlerësimit të performancës së prokurorëve;
- Forcimin e lidhjes së vlerësimit vjetor me vlerësimin trevjeçar.

Bazuar në të dhënat e pranura nga KPK sa i përket realizimit të këtyre aktiviteteve, KPK ka bërë analizën e rregullores paraprake, janë konstatuar sfidat dhe së bashku me partnerët ndërkombëtar janë përcaktuar parimet bazë mbi të cilat do të duhej të krijoheshin rregullorja dhe sistemi i ri i vlerësimit të performancës së prokurorëve. Këshilli ka krijuar grupin punues i cili e ka hartuar draft rregulloren dhe është miratuar nga këshilli.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 6. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së katërt të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.5 FUQIZIMI I MËTEJME I SISTEMIT TË REKRUTIMIT

Objektiva e 5 e Planit të Punës së KPK-së përfshin implementimin e 6 aktiviteteve, disa prej të cilave me afat të përmbylljes deri në qershor 2020. Nga këto 6 aktivitete të parapara në këtë periudhë, nga KPK është arritur të realizohet vetëm 1 prej tyre.

Aktiviteti i realizuar i kësaj objektive ishte:

- Analiza afatgjate e nevojave për rekrutimin e prokurorëve dhe rekrutimin e prokurorëve sipas nevojës;


Aktivitetet që nuk kanë arritur të finalizohen ishin:

- Rishikimi i procesit të rekrutimit të prokurorëve;
- Propozim-rekomandimet për ndryshime legjislative;
- Avancimi i mekanizmave për rekrutim të prokurorëve;
- Avancimi i kriterëve të vlerësimit gjatë provimit dhe rekrutimit;
- Rekrutimi i prokurorëve të rinj.

Bazuar në të dhënat e ofruara nga ana e KPK-së, shkak kryesor i mos përmbushjes së këtyre aktiviteteve ishte situata e krijuar pas përhapjes së pandemisë COVID-19 në mars të vitit 2020, ku si rezultat i numrit të madh të kandidatëve për vlerësim, është pamundësuar mbajtja e fazave të tjera të vlerësimit dhe janë stagnuar shumë iniciativa për ndryshime legjislative.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nga kjo objektive kemi gjetur të dhëna për realizimin e 1 aktiviteti (që përfshinte publikimet e konkurseve për rekrutimin e prokurorëve të rinj, e që për shkak të pandemisë nuk mund të procedoheshin më tutje).

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 7. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së pestë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.6 AVANCIMI I ROLIT INSTITUCIONAL NË PROCESET BUXHETORE

Në këtë objektivë ishte paraparë realizimi i 7 aktiviteteve, të cilat ishin përmbushur në tërësi nga ana e KPK-së.

Aktivitetet e kësaj objektive ishin:

- Konsultime për planifikim buxhetor me prokurori;
- Planifikimi buxhetor i bazuar në nevoja dhe orientime strategjike;
- Rishikimi i buxhetit për vitin 2020 që reflekton nevojat dhe ndryshimet eventuale të sistemit;
- Miratimi i KASH-it dhe buxhetit për vitin 2021-2023 i bazuar në nevoja dhe strategji të sistemit prokurorial;
- Mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Vlerësimi i rregullt i shpenzimeve si dhe sigurimi i ekzekutimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Avancimi i procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 8. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së gjashtë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.7 AVANCIMI I SISTEMIT TË DISIPLINIMIT

Objektiva e 7 e Planit të Punës së KPK-së përfshinë implementimin e 3 aktiviteteve, të cilat po ashtu ishin përmbushur në tërësi nga ana e KPK-së.

Këto aktivitete ishin:

- Formimin e paneleve hetimore bazuar në ligjin dhe rregulloren përkatëse për disiplinim të prokurorëve;
- Përgatitjen dhe mbështetjen e paneleve për shqyrtimin e rasteve disiplinore;
- Zhvillimin e seancave disiplinore lidhur me paraqitjet për shkelje disiplinore ndaj prokurorëve.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemi Prokurorial, nga kjo objektivë kemi gjetur të dhëna për realizimin e 1 aktiviteti (që përfshinte vendimin e KPK-së për themelimin e paneleve hetimore për hetimin e rasteve disiplinore).

Sipas përgjigjes së pranuar nga ana e KPK-së, gjatë vitit 2020 janë themeluar panelet hetimore varësisht nga numri i kërkesave për fillim të procedurës disiplinore, siç përcaktohet me ligj.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuara nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 9. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së shtatë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.8 AVANCIMI I STATUSIT DHE ROLIT TË STAFIT ADMINISTRATIV


Objektiva e 8 e Planit të Punës së KPK-së përfshinë implementimin e 1 aktiviteti, i cili nuk kishte arritur të realizohet gjatë vitit 2020.

Ky aktivitet ishte:

- Rregullimi i procesit të rekrutimit, klasifikimit, transferimit, vlerësimit dhe avancimit të stafit administrativ të sistemit prokurorial.

Sipas përgjigjes së KPK-së, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjin për zyrtarët publik, KPK është ende në pritje të amandamentit të këtij ligji i cili ia jep të drejtën KPK-së për riorganizimin e administratës, prandaj realizimi i këtij aktiviteti është pamundësuar.

Realizimi i kësaj objekte (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 10. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së tetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.9 TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE MEDIET

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 7 aktiviteteve, 6 prej të cilave ishin realizuar në tërësi, ndërsa 1 prej tyre nuk kishte arritur të përmbushet në kohën e paraparë.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objektive ishin:

- Krijimi i qasjes në një portal unik të sistemit prokurorial;
- Zhvillimi i intranetit për komunikim të brendshëm;
- Mbajtja e takimeve të rregullta me shoqërinë civile dhe me media – zhvillimi i planit për takime;
- Organizimi i kampanjave informuese – zhvillimi i planit për kampanja;
- Hartimi i manualit për procedura standarde të veprimit për komunikim efektiv me publikun;
- Rishikimi i strategjisë për komunikim me publikun dhe media.


Ndërkaq aktiviteti që nuk ishte përfunduar ishte:

- Standardizimi dhe unifikimi i informacionit të brendshëm dhe të jashtëm të prokurorive.

Sa i përket aktivitetit të përfunduar, sipas të dhënave të pranura nga KPK, ka filluar hartimi i një drafti të këtij dokumenti në bashkëpunim me projekt-mbështetës ndërkombëtar, mirëpo nuk ka arritur të finalizohet ende.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 11. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të përfunduara të objektivës së nëntë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.10 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE, I MBËSHTETUR NË RESPEKT RECIPROK

Objektiva e 10 e Planit të Punës së KPK-së përfshinte implementimin e 2 aktiviteteve, të cilat ishin përmbushur në tërësi nga ana e KPK-së.

Aktivitetet që ishin realizuar të parapara në këtë objektivë ishin:

- Arritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KGJK-në, Ministrinë e Drejtësisë, Akademinë e Drejtësisë, Policinë e Kosovës dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit;
- Mbjajtja e tryezave të diskutimit dhe takimeve të ndryshme me sektorin jo qeveritar.

Sipas përgjigjes së KPK-së, gjatë kësaj kohe ishin nënshkruar 8 Memorandume Bashkëpunimi me institucione të ndryshme të zbatimit të ligjit, si dhe janë mbajtur takime me sektorin jo qeveritar sipas kërkesave dhe nevojave për takime.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 12. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së dhjetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.11 BASHKËPUNIMI ME PARTNERË DHE DONATORË (BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR\ BASHKËPUNIMI I JASHTËM)

Kjo objektivë përfshinte realizimin e 8 aktiviteteve, 6 prej të cilave ishin realizuar, ndërsa pjesa tjetër prej 2 aktiviteteve nuk kishin arritur të përmbushen në tërësi.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objektivë ishin:


- Përcaktimi i prioriteteve për procesin e integriteteve evropiane;
- Krijimi i një mekanizmit koordinues/ ndërlidhës;
- Vlerësimi i rezultateve të arritura nga projektet e kaluara;
- Pjesëmarrja aktive në forume koordinuese me donatorë në nivel vendi, si dhe vazhdimi i zbatimit të projekteve aktuale;
- Vlerësimi i nevojave për mbështetje nga donatorët;
- Krijimi i një mekanizmi koordinues / ndërlidhës.

Ndërkaq aktivitetet që nuk kishin arritur të përmbushen në kohën e përcaktuar ishin:

- Mbajtja e takimeve koordinuese me donatorë;
- Lidhja e marrëveshjeve me institucione dhe forume të cilat ushtrojnë mandat të njëjtë.

Bazuar në të dhënat e pranuar nga ana e KPK-së në lidhje me aktivitetet që nuk kanë arritur të realizohen, takimet e përbashkëta me të gjithë donatorët nuk ishin realizuar gjatë vitit 2020 për shkak të situatës me pandeminë COVID-19 dhe se marrëveshje bashkëpunimi për këtë çështje nuk janë nënshkruar, mirëpo janë nënshkruar projekte. Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektivë.

Realizimi i kësaj objektivë (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 13. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së njëmbëdhjetë të linit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.12 SIGURIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE ADEKUATE

Kjo objektivë parasheh implementimin e 3 aktiviteteve, 2 prej të cilave kanë arritur të përmbushen në tërësi, ndërsa 1 aktivitet nuk ishte finalizuar ende.

Aktivitetet që ishin realizuar ishin:

- Pajisja e Këshillit dhe Prokurorive me inventar adekuat dhe pajisje për punë;
- Krijimi i hapësirave adekuate, përfshirë infrastrukturën përcjellëse për KPK dhe ZKPSH-në, PSRK-në, PTh të Gjakovës dhe vlerësim të nevojave për prokuroritë tjera.


Ndërkaq aktiviteti që nuk ishte realizuar plotësisht ishte:

- Sigurimi i parcelës për ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës.

Sipas informatave të pranura nga KPK, për shkak të planit urbanistik të pa aprovuar nga Kuvendi Komunal Lokal, sigurimi i parcelës për ndërtimin e objektit të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës nuk ka arritur të finalizohet.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, kemi arritur të gjejmë të dhëna për realizimin e 1 aktiviteti të kësaj objektive (aprovimi i kërkesës buxhetore).

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 14. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së dymbëdhjetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.13 AVANCIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE


Për implementimin e kësaj objektive ishin planifikuar të realizohen 7 aktivitete, të cilat ishin përmbushur në tërësi nga ana e KPK-së. Këto aktivitete ishin:

- Sigurimi i teknologjisë informative adekuate për digjitalizim të proceseve të punës;
- Ndërtimi i një sistemi standard të arkivave (fizik, elektronik) në Prokurorin e Shtetit;
- Hartimi i programeve të trajnimit dhe organizimi i trajnimeve;
- Avancimi i data bazës për dosjet elektronike të prokurorëve;
- Zbatimi i sistemit elektronik të aplikimit për prokurorë të rinj;
- Aplikimi i plotë i SIMBNj-së;
- Zhvillimi dhe aplikimi i data bazave të brendshme për menaxhimin e proceseve të punës në sistemin prokurorial.

Sipas informatave të pranuar nga KPK, të gjitha prokurorit janë furnizuar me pajisje të TI, bazuar në planin e shpërndarjes së pajisjeve. Gjithashtu janë montuar raftet lëvizëse në Gjiilan, Prishtinë, Gjakovë, Prizren dhe në Apel. Ka mbetur vetëm edhe PSRK, për shkak të renovimit, ndërsa Ferizaji dhe Peja e kanë përfunduar gjatë vitit 2019. Gjithashtu, sipas këtyre informatave, është bërë avancimi i plotë i sistemit elektronik të menaxhimit të dosjeve të prokurorëve duke përfshirë edhe pjesën e aplikimit dhe testimit online për pozitën e prokurorit.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 15. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së trembëdhjetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.14 AVANCIMI I SISTEMIT TË ZHVILLIMIT TË KARRIERËS (FUQIZIMI I SISTEMIT TË TRANSFERIMIT DHE AVANCIMIT TË PROKURORËVE)

Objektiva e 14 e Planit të Punës së KPK-së përfshinte implementimin e 5 aktiviteteve, 3 prej të cilave ishin realizuar, ndërsa 2 nuk ishin finalizuar ende.

Aktivitetet e realizuara ishin:

- Vlerësimi afatgjatë për transferime dhe avancime;
- Krijimi i mekanizmave për transferim dhe avancim;
- Përcaktimi i kriterëve për transferim dhe avancim bazuar në rezultatet e punës.


Ndërsa aktivitetet e porealizuara ishin:

- Rishikimi i akteve nënligjore për procedurat e transferimit dhe avancimit;
- Rishikimi i procesit të transferimit;

Sipas përgjigjes së pranuar nga ana e KPK-së, pamundësimi i realizimit të këtyre aktiviteteve ishte si rezultat i situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, që ka bërë që të shtyhen iniciativat për ndryshime legjislative sa i përket transferimit dhe avancimit të prokurorëve.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna për ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 16. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së katërbëdhjetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.15 TRAJTIMI I RASTEVE TË BARTURA

Kjo objektivë e Planit të Punës së KPK-së përfshinte implementimin e 6 aktiviteteve të KPK-së të cilat ishin përmbushur në tërësi nga ana e KPK-së.

Këto aktivitete ishin:

- Vlerësimi dhe analizimi i gjendjes së lëndëve të bartura;
- Analiza e lëndëve lidhur me rastet penale;
- Vlerësimi i normës orientuese;
- Vlerësimi i trendëve të lëndëve të reja;
- Trajtimi i rasteve të parashkruara;
- Transferimet e prokurorëve sipas nevojave të prokurorive.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet nga realizimi i këtyre aktiviteteve.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 17. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së pesëmbëdhjetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

3.16 NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE DHE SHKATHTËSIVE PRAKTIKE TË PROKURORËVE DHE PERSONELIT


Kjo objektivë parashihte implementimin e 2 aktiviteteve, të cilat ishin përfunduar në tërësi nga ana e KPK-së.

Këto aktivitete ishin:

- Përcaktimi i politikave të trajnimit (3 vjeçare);
- Ndërlidhja e sistemit të rekrutimit, performancës dhe trajnimeve.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna nga realizimi i këtyre aktiviteteve.

Realizimi i kësaj objektivë (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 18. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së gjashtëmbëdhjetë të Planit të Punës së KPK-së për vitin 2020.

4. SEKRETARIATI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

4.1 FUQIZIMI I KOORDINIMIT, BASHKËPUNIMIT, KOMUNIKIMIT DHE LLOGARIDHËNIES

Objektiva e parë e Sekretariatit të KPK-së përfshinte implementimin e 11 aktiviteteve. Prej këtyre aktiviteteve, sipas informatave të pranuar nga ana e KPK-së, vetëm 1 aktivitet nuk kishte arritur të realizohet.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objekte ishin:

- Organizmi i punës në ekip në formë gjithëpërfshirëse;
- Planifikimi dhe zbatimi në kohë i proceseve të punës;
- Mbështetja në ofrimin e shërbimeve sipas nevojave të trupave të KPK dhe PSh;
- Komunikimi interaktiv dhe ofrimi transparent, cilësor dhe sasior i informacionit të jashtëm për sistemin prokurorial;
- Standardizimi i proceseve të punës;
- Kontrollimi paraprak i proceseve të prokurimit, financave, shërbimeve të përgjithshme dhe personelit (udhëheqësit e njësive organizative, auditori, certifikuesit dhe Zyra Ligjore);
- Ofrimi i mbështetjes për KPK dhe PSh lidhur me koordinimin e partnerëve dhe donatorëve për zhvillim institucional;
- Hartimi i planit të prokurimit sipas vlerësimit dhe identifikimit të nevojave për sistemin prokurorial;
- Mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit të planit të prokurimit;
- Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm.


Ndërkaq aktiviteti që nuk ishte realizuar ishte:

- Rishikimi i strukturës organizative të administratës së sistemit prokurorial.

Sipas të dhënave të pranuar nga KPK, për shkak të situatës së krijuar me pandeminë COVID-19 planifikimet për rishikimin e strukturës së administratës janë shtyrë për vitin 2021. Ndërkaq të gjitha punët për të cilat shprehet nevoja për punë në grupe janë realizuar përmes themelimit të komisioneve apo grupeve punuese të cilat në koordinim të plotë kanë realizuar aktivitetet për të cilat janë themeluar.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 19. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së parë së Sekretariatit të KPK-së për vitin 2020.

4.2 FUQIZIMI I PLANIFIKIMIT, SIGURIMIT, MENAXHIMIT DHE SHPENZIMIT TË BUXHETIT SIPAS NEVOJAVE TË SISTEMIT PROKURORIAL

Objektiva e dytë e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës përfshinte implementimin e 13 aktiviteteve. Sipas informatave të pranura nga ana e KPK-së, prej këtyre 13 aktiviteteve, KPK kishte realizuar 8 aktivitete, ndërsa 5 prej tyre nuk ishin finalizuar ende.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objektive ishin:

- Përgatitja e draft KASH-it dhe buxhetit për vitin 2021-2023 i bazuar në nevoja dhe strategji të sistemit prokurorial;
- Sigurimi i shlyerjes së obligimeve financiare me kohe;
- Mbështetje e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel;
- Raportimi i rregullt financiar;
- Mbylljet e vitit fiskal pa obligime përmes rialokimeve apo transfereve brenda buxhetit të Këshillit;
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;
- Menaxhimi i rrezikut në realizimin e planit të departamentit;
- Menaxhimi i pasurisë së sistemit prokurorial.


Ndërkaq aktivitetet të cilat nuk ishin finalizuar ende ishin:

- Zbatimi i projekteve kapitale sipas planifikimeve dhe nevojave;
- Analizimi dhe shpërndarja e shpenzimeve për vitin 2020 sipas nevojave dhe historikut të shpenzimeve;
- Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022-2023;
- Funksionalizimi i bazës së brendshme të financave;
- Përgatitja e raportit dhe pyetësorit të vetëvlerësimit sipas ligjit për menaxhim dhe kontroll.

Sipas të dhënave të pranura nga KPK, auditimi i brendshëm për vitin 2020 ka dhënë dy rekomandime për divizionin për buxhet dhe financa, rekomandime të cilat janë zbatuar gjatë vitit. Ndërkaq sa i përket menaxhimit të pasurisë së sistemit prokurorial, ajo bëhet përmes sistemeve që janë në përdorim, pra përmes platformës online E-pasuria dhe SIMFK-ja. Që të dy këto sisteme, sipas KPK-së, janë platforma online që pasuria menaxhohet duke i përditësuar të dhënat sipas nevojës apo kërkesave.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, kemi arritur të gjejmë të dhëna për realizimin e 2 aktiviteteve.

Realizimi i kësaj objektivë (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 20. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së parë të Sekretariatit të KPK-së për vitin 2020.

4.3 SIGURIMI I SHËRBIMEVE, INFRASTRUKTURËS DHE NGRITJA E NIVELIT TË SIGURISË NË SISTEMIN PROKURORIAL


Kjo objektivë përfshinte implementimin e 5 aktiviteteve, të cilat ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së.

Aktivitetet e kësaj objektivë ishin:

- Vlerësimi i kushteve të punës në të gjitha objektet, përfshirë objektet / hapësirat shtesë dhe inventarin;
- Rritja e efikasitetit të shërbimeve të transportit;
- Identifikim i nevojave dhe përgatitja e planit për zbatim të projekteve kapitale;
- Finalizimi dhe zbatimi i planit adekuat të sigurisë në të gjitha objektet e punës;
- Përgatitja dhe propozimi i akteve të brendshme për zbatim të planit të sigurisë.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektivë.

Realizimi i kësaj objektivë (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 21. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së tretë të Sekretariatit të KPK-së për vitin 2020.

4.4 FUQIZIMI I BURIMEVE NJERËZORE NË PLANIFIKIMIN DHE ZBATIM TË PROCESEVE TË PUNËS

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 10 aktiviteteve, 9 prej të cilave ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objektive ishin:


- Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave në fushën e burimeve njerëzore;
- Hartimi dhe zbatimi i planit të personelit;
- Zhvillim i kapaciteteve profesionale të stafit;
- Rishikimi dhe nivelizimi i pozitave sipas vlerësimit, nevojës dhe kërkesave;
- Aplikimi online për të gjitha proceset e burimeve njerëzore;
- Hartim i koncept dokumentit lidhur me tarifat e përkthimit të ekspertëve gjuhësor;
- Mbështetje në sigurimin e infrastrukturës nënligjore;
- Funksionalizim i plotë i Arkivës elektronike;
- Sigurimi i infrastrukturës fizike dhe pajisjeve për arkiva.

Aktiviteti që nuk kishte arritur të finalizohet ende ishte:

- Sigurim i zbatimit të menaxhimit të pagave dhe shpërblimeve përmes SIMBNJ.

Sipas informatave të pranuar nga ana e KPK-së, realizimi i këtij aktiviteti nuk ka mundur të realizohet për shkak të mos-funksionimit të SIMBNJ nga ministria përgjegjëse. Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, ne kemi arritur të gjejmë të dhëna për publikimin e 1 aktiviteti të kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 22. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së katërt të Sekretariatit të KPK-së për vitin 2020.

4.5 ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 14 aktiviteteve, 12 prej të cilave ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së, ndërsa 2 nuk ishin finalizuar ende.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objektive ishin:

- Avancimi i SMIL-it për të gjitha instancat e prokurorive (Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit);
- Ndërlidhja e SMIL me sistemin e Gjykatave;
- Aplikimi i shpërndarjes së lëndëve në mënyrë elektronike;
- Avancimi i ndërlidhjes së SMIL me sistemin e Policisë së Kosovës;
- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit elektronik për menaxhimin e rasteve në ZMNV;
- Siguria punës së sistemeve Qendra e Rimëkëmbjes (Backup- BCC) në Prokurorinë Themelore Gjakovë;
- Furnizim dhe instalim për sallën e të miturve;
- Avancimi i të gjitha niveleve të sigurisë së sistemeve përfshirë auditimin e sigurisë kibernetike;
- Mbështetje në hartimin e Udhëzuesit për përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve;
- Mbështetje në hartimin e draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit për ndërlidhje të sistemit elektronik të KPK-së me sistemin elektronik të KGJK-së;
- Përgatitja e draft Procedurës Standarde të Veprimit për ndërlidhjen e sistemit elektronik të KPK-së dhe KGJK-së;
- Përgatitja e draft Marrëveshjes së bashkëpunimit për ndërlidhjen e sistemeve elektronike ndërmjet KPK-së dhe Administratës Tatimore të Kosovës.


Aktivitetet që nuk kishin arritur të finalizohen ende ishin:

- Përgatitja e Procedurës Standarde të Veprimit për ndërlidhjen e sistemit elektronik të KPK – së dhe ATK-së;
- Përgatitja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për ndërlidhjen e sistemeve elektronike ndërmjet KPK – së dhe Doganës së Kosovës.

Sipas të dhënave të pranura nga KPK, avancimi i SMIL-it nuk është arritur ende në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ndërsa në Prokurorinë e Apelit është vënë në zbatim. Gjithashtu sipas këtyre informatave, në muajin Shtator 2020 ka filluar implementimi i ndërlidhjes elektronike përmes SMIL në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë themelore të Kosovës. Në muajin shkurt 2020 është vënë në zbatim shkëmbimi elektronik i të dhënave në të gjitha Prokuroritë Themelore, përfshirë edhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës me Policinë e Kosovës.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nga kjo objektivë kemi arritur të gjejmë të dhëna të publikuara në lidhje me realizimin e 1 aktiviteti.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 23. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së pestë të Sekretariatit të KPK-së për vitin 2020.

5.NJËSITI PËR SHQYRTIMIN E PERFORMANCËS SË PROKURORISË

5.1 AVANCIMI I PROCESEVE TË BRENDSHME TË PUNËS

Objektiva e parë e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës parashihte realizimin e 3 aktiviteteve, prej të cilave 2 ishin realizuar në tërësi.

Aktivitetet e realizuara të kësaj objektive ishte:


- Standardizimi i sistemit të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave statistikore;
- Caktimi i procedurave standarde për komunikim të brendshëm.

Ndërsa aktivitetet që nuk kishin arritur të finalizohen ende ishin:

- Rishikimi kornizës organizative dhe funksionale.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 24. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së parë të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së KPK-së për vitin 2020.

5.2 MBËSHTETJA E KPK-SË DHE PSH-SË NË ADMINISTRIMIN E PROCESEVE TË PUNËS DHE SHQYRTIMIN E PERFORMANCËS SË PROKURORIVE

Kjo objektivë parashihte realizimin e 13 aktiviteteve, 10 prej të cilave ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së, ndërsa 3 prej tyre nuk kishin arritur të finalizohen.

Aktivitetet e kësaj objektive që kishin arritur të realizohen ishin:

- Mbështetja në administrimin e procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve;
- Administrimi i procesit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve
- Monitorimi i trendëve kuantitative të trajtimit të rasteve kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, trafikimi me qenie njerëzore dhe krimi kibernetik;
- Mbështetja e mekanizmave për monitorimin e punës së prokurorëve sipas kërkesës së KPK-së;
- Organizimi i vizitave në prokurori për mbikëqyrjen e mirëmbajtjes së regjistrave dhe arkivimin e lëndëve;
- Mbështetja në hartimin dhe zbatimin e strategjive të sistemit prokurorial;
- Hartimi i draft planeve të punës së sistemit prokurorial – mandati i NJSHPP;
- Hartimi i raporteve periodike për performancën e prokurorive;
- Vlerësimi afatgjatë për transferime dhe avancime;
- Hartimi i Analizës afatgjatë e nevojave për rekrutimin e prokurorëve.


Ndërkaq aktivitetet e kësaj objektive që nuk ishin finalizuar ende ishin:

- Zbatimi i planit vjetor për vlerësimin e performancës së prokurorëve sipas kërkesave të Komisionit;
- Administrimi i procesit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve;
- Zbatimi i Planit të Punës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive.

Sipas të dhënave të pranuar nga KPK, në të gjitha aktivitetet e realizuara të kësaj objektive është siguruar mbështetje administrative.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nga kjo objektive kemi gjetur të dhëna për realizimin e 4 aktiviteteve.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 25. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së dytë të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së KPK-së për vitin 2020.


5.3 ANALIZIMI I PUNËS SË PROKURORËVE DHE PROKURORIVE

Kjo objektivë parashihte realizimin e 10 aktiviteteve, të cilat ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së.

Këto aktivitete ishin:

- Grumbullimi dhe përpunimi i shënimeve statistikore për veprimet, ngarkesën dhe efikasitetin e punës së prokurorëve;
- Grumbullimi dhe përpunimi i shënimeve statistikore për veprimet, ngarkesën dhe efikasitetin e punës së prokurorive;
- Grumbullimi dhe përpunimi i shënimeve statistikore për veprimet, ngarkesën dhe efikasitetin e punës së prokurorive për veprat penale karakteristike;
- Grumbullimi dhe përpunimi i shënimeve statistikore për veprimet, ngarkesën dhe efikasitetin e punës së prokurorive për procedurat alternative;
- Grumbullimi dhe përpunimi i shënimeve statistikore për veprimet, ngarkesën dhe efikasitetin e punës së prokurorive për proceset e integritetit evropiane;
- Analizimi i shënimeve statistikore për lëndët me kryes të panjohur;
- Hartimi i raportit periodik dhe vjetor të mekanizmit përcjellës për vitin 2020;
- Vlerësimi i trendeve të lëndëve të reja;
- Hartimi i raportit për vlerësimin e lëndëve të hudhura;
- Organizimi i vizitave në prokurori për mbikëqyrjen e mirëmbajtjes së lëndëve dhe regjistrave.

Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial kemi arritur të gjejmë të dhëna vetëm për realizimin e 1 aktiviteti. Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranura nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 25. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës të tretë të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së KPK-së për vitin 2020.

5.4 VLERËSIMI I APLIKIMIT TË SISTEMEVE DIGJITALE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE

Kjo objektivë parashihte realizimin e 10 aktiviteteve, të cilat po ashtu ishin realizuar në tërësi nga ana e KPK-së.

Këto aktivitete ishin:

- Vlerësimi i funksionalitetit të SEMDP-së;
- Propozimi dhe dizajnimi i moduleve shtesë në SEMDP -së;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i shënimeve dhe informatave në SEMDP;
- Mirëmbajtja e dosjeve të prokurorëve;
- Zbatimi i sistemit elektronik për rekrutimin e prokurorëve të rinj;
- Organizimi i vizitave në prokurori për mbikëqyrjen e zbatimit të SMIL-it;
- Monitorimi i funksionimit të SMIL;
- Dizajnimi i raporteve statistikore që gjenerohen nga SMIL;
- Mirëmbajtja e shënimeve për databazën NORMA;
- Mirëmbajtja e shënimeve për databazën “KrimKorr”.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna të publikuara nga realizimi i këtyre aktiviteteve.

Realizimi i kësaj objektivë (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 23. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së tretë të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së KPK-së për vitin 2020.

5.5 MBËSHTETJA E NGRITJES SË KAPACITETEVE PROFESIONALE NË SISTEM PROKURORIAL

Kjo objektivë parashihte realizimin e 5 aktiviteteve, prej të cilave vetëm 1 nuk kishte arritur të finalizohet.

Aktivitetet e realizuara ishin:


- Vlerësimi i nevojave për trajnime;
- Hartimi i draft politikave për trajnim;
- Grumbullimi, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për pjesëmarrje në trajnime;
- Monitorimi i pjesëmarrjes në trajnime të detyrueshme të përcaktuara nga Këshilli.

Ndërkaq aktiviteti që nuk kishte arritur të realizohet ishte:

- Hartimi i Raportit për vlerësim të ndikimit të trajnimeve (version i pilotuar).

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial kemi arritur të gjejmë të dhëna për realizimin e 1 aktiviteti.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KPK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Grafikoni 23. Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së tretë të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së KPK-së për vitin 2020.

6. REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS SË PROKURORIT TË SHTETIT (PSh) 2020

Plani i Punës së Prokurorit të Shtetit (PSh) i vitit 2020 parashihte realizimin e 6 objektivave, qëllimi i të cilave ishte avancimi i punës profesionale, fuqizimi i pavarësisë dhe i besimit të publikut tek ky institucion, forcimin e luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe modernizimin dhe digjitalizimin e punës së këtij institucioni..

Me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave, ky plan parashihte ndërmarrjen e disa aktiviteteve, të cilat ndryshe nga Plani i Punës së KPK-së, nuk përcaktonin ndonjë afat kohor të përmbylljes.

Në vijim të këtij raporti janë shtjelluar të dhënat në lidhje me niveli i realizimit të aktiviteteve të secilës objektivë të këtij plani, si dhe se sa prej aktiviteteve të realizuara janë publikuar në ueb-faqen e Sistemit Prokurorial.

6.1 AVANCIMI I PUNËS PROFESIONALE TË PROKURORIT TË SHTETIT PËR HETIMIN DHE PËRFAQËSIMIN E RASTEVE

Realizimin e kësaj objektivë, PSh planifikonte ta bënte përmes këtyre mekanizmave:

- Grupe punese me tryeza të punës dhe takime të rregullta me Policinë dhe institucionet e sundimit të ligjit;
- Trajnime për përcaktimin e standardeve dhe praktikave më të mira;
- Pjesëmarrja e prokurorëve në grupet punuese për hartimin e legjislacionit për drejtësi penale;
- Monitorim të punës së prokurorëve nga prokurorët e ZKPSH-së të cilët janë përgjegjës për secilën prokurori;
- Pjesëmarrje të prokurorëve të ZKPSH në kolegji me kolegji të prokurorëve me qëllim të ofrimit të këshillave dhe udhëzimeve në funksion të fuqizimit të llogaridhënies;
- Hartimi i udhëzuesve për udhëheqje të hetimeve;
- Kolegji me kolegji të rregullta me kryeprokurorë;
- Raportime të rregullta të kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit në ZKPSH për rastet e hushkimit dhe pushimit të hetimeve.

Sipas të dhënave të pranuar nga PSh, asnjë aktivitet i kësaj objektive nuk ka mbetur i parealizuar. Sipas këtyre të dhënave, edhe pse të ballafaquar me pandeminë COVID-19, ku si pasoj janë kufizuar aktivitetet e Prokurorit të Shtetit, megjithatë gjatë vitit 2020 janë mbajtur disa trajnime online ndërmjet platformave të ndryshme në Akademinë e Drejtësisë, por edhe me projektet e partnerëve ndërkombëtarë, në veçanti me projektet e Ambasadës Amerikane në Kosovë, Ambasadës së Britanisë së Madhe, Ambasadës së Mbretërisë së Holandës, UNDP-së etj. Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qenë 163 prokurorë të të gjitha niveleve, apo 86 % e prokurorëve të shtetit.

Megjithatë gjatë hulumtimit në ueb-faqen e Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna të publikuara në lidhje me realizimin e këtyre aktiviteteve.

6.2 FORCIMI I BESIMIT TË PUBLIKUT SE PROKURORI I SHTETIT ËSHTË PROFESIONAL, TRANSPARENT, LLOGARIDHËNËS, EFIKAS, EFEKTIV, ME INTEGRITET DHE I PAVARUR

Realizimin e kësaj objektive, PSh planifikonte ta bënte përmes këtyre mekanizmave:

- Trajnimi i personelit dhe monitorimit sistematik të punës në të gjitha prokuroritë;
- Angazhimi i prokurorëve në aktivitete që kanë për qëllim informimin e publikut për punën e prokurorit të shtetit;
- Ofrimi i shërbimeve 24 orëshe për viktimat dhe dëshmitarët;
- Vlerësimi vjetor i prokurorëve nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse;
- Trajnimi adekuat i prokurorëve dhe i stafit, si dhe aktivitete të përbashkëta me aktorë relevant për krijimin e kushteve për komunikim efektiv me viktimat;
- Përmes ofrimit nga ana e koordinatorëve të caktuar nga Kryeprokurori i Shtetit të trajnimeve për prokurorët përgjegjës për raportimin e rregullt;
- Informimit, trajnimeve adekuate dhe udhëzimeve përkatëse për zbatimin efikas të sistemit të ri të disiplinimit të prokurorëve.

Sipas të dhënave të ofruara nga PSh, aktivitetet e kësaj objektive ishin realizuar në tërësi nga ana e PSh-së. Sipas këtyre të dhënave, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2020 ka arritur të zgjidhë 6,408 lëndë penale, ose 15,20 % më shumë se sa ka pranuar në punë.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë aktivitet të publikuar nga realizimi i kësaj objektive.

6.3 FORCIMI I LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Realizimin e kësaj objektive, PSh planifikonte ta bënte përmes këtyre mekanizmave:

- Zbatimi i Planit Strategjik të PSRK-së;
- Rritja e numrit të prokurorëve në PSRK dhe rekrutimit të personelit të nevojshëm profesional,
- Trajnime të specializuara;
- Krijimi i kushteve adekuate për punë të prokurorëve;
- Takime të rregullta të ekipit për shënjestrimin e rasteve;
- Monitorimit dhe raportimit të rregullt të Komisionit mbikëqyrës për rastet e korrupsionit dhe krimeve ekonomike;
- Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e nivelit vendor dhe ndërkombëtar me qëllim të avancimit të sistemit të drejtësisë;
- Komunikim i rregullt i prokurorëve me hetuesit e rasteve.

Sipas të dhënave të ofruara nga PSh, asnjë aktivitet i kësaj objektive nuk ka mbetur i parealizuar. Sipas këtyre të dhënave, me qëllim të riorganizimit, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Prokurorisë Speciale, krahas Departamentit për Krime të Luftës, i cili ishte themeluar në vitin 2015, në këtë prokurori janë themeluar edhe tri departamente të reja: Departamenti për Krim të Organizuar dhe Krime të Tjera në Kompetencë të PSRK-së, Departamenti për Terrorizëm, si dhe Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar. Po ashtu, në këtë prokurori është shtuar edhe numri i prokurorëve të rinj, të cilët janë shpërndarë në departamentet përkatëse.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, kemi arritur të gjejmë të dhëna në lidhje me realizimin e vetëm 1 aktiviteti të kësaj objektive.

6.4 DIGJITALIZIMI DHE MODERNIZIMI I PUNËS SË PROKURORIT TË SHETIT

Realizimin e kësaj objektive, PSh planifikonte ta bënte përmes këtyre mekanizmave:

- Memorandume të Bashkëpunimit me BQK-në, ATK-në, Doganën dhe agjenci të tjera me qëllim të sigurimit të informatave për hetimin dhe ndjekjen efikase të kryerësve të veprave penale;
- Finalizimit të platformës së SMIL-it dhe regjistrimit të lëndëve të reja dhe të vjetra në sistem;
- Tryeza të punës dhe broshura për njoftimin e zbatimit të SMIL-it;
- Aplikimin e programeve të specializuara të trajnimit;
- Identifikimit të nevojave, ndarjes së mjeteve buxhetore dhe sigurimit të pajisjeve në kohë;
- Mbikëqyrjes së rregullt të zbatimit dhe hartimit të raporteve.

Sipas të dhënave të ofruara nga PSh, asnjë aktivitet i kësaj objektive nuk ka mbetur i parealizuar. Sipas këtyre të dhënave, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2020 ka arritur përmes Departamentit të Teknologjisë Informative të vë në zbatim të plotë sistemin SMIL në të gjitha Prokuroritë Themelore, përfshirë edhe Prokurorinë Speciale dhe Prokurorinë e Apelit. Po ashtu, gjatë vitit 2020 të gjitha lëndët e pranuar janë regjistruar në sistemin SMIL. Gjatë periudhës janar – nëntor 2020 janë regjistruar 30,873 lëndë, ndërsa në Prokurorinë e Apelit nga muaji shtator – nëntor janë regjistruar 1,037 lëndë.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial, ne kemi arritur të gjejmë të dhëna në lidhje me realizimin e 1 aktiviteti (Memorandumi i Bashkëpunimit me ATK-në) të kësaj objektive.

6.5 FORCIMI I PAVARËSISË, PAANSHMËRISË DHE INTEGRITETIT TË PROKURORIT TË SHETIT.

Realizimin e kësaj objektive, PSh planifikonte ta bënte përmes këtyre mekanizmave:

- Trajnimeve dhe udhëzimeve specifike për rastet e prioritizuara;
- Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e nivelit vendor dhe ndërkombëtar me qëllim të avancimit të sistemit të drejtësisë;
- Mbajtja e rregullt e kolegjiave;
- Takime të rregullta dhe forma të bashkëpunimit formal, përmes marrëveshjeve të ndryshme.

Sipas përgjigjes së PSh-së, të gjitha aktivitetet e parapara në këtë objektivë ishin realizuar, përveç mbajtjes së kolegjiave të Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokurorët e prokurorive të cilat nuk kanë mundur të mbahen në mënyrë të rregullt për shkak të pandemisë COVID-19. Sipas kësaj përgjigjeje, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2020 ka trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë para ligjit të gjithë pa marrë parasysh statusin e tyre në procedurë. Gjithashtu, janë propozuar masa adekuate ndaj personave të akuzuar.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna në lidhje me realizimin e ndonjë aktiviteti të kësaj objektive.

6.6 RRITJA E SHKALLËS SË SEKUESTRIMIT TË ASETVE TË FITUARA ME VEPËR PENALE

Realizimin e kësaj objektive, PSh planifikonte ta bënte përmes këtyre mekanizmave:

- Nxjerrjes së udhëzimeve;
- Tryezave të punës dhe trajnimeve;
- Monitorimit;
- Raportimit.

Sipas të dhënave të pranura nga ana e PSh-së, të gjitha këto aktivitete ishin realizuar. Sipas këtyre të dhënave, në luftën efikase kundër krimeve ekonomike, në veçanti në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme në kuadër të Sistemit Prokurorial, PSh ka caktuar Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (KKLKE). Si rezultat i qasjes shumëdimensionale dhe koordinimit ndër-institucional nga KKLKE-ja, gjatë vitit 2020 janë shënuar disa rezultate në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar me vepër penale. Sipas këtyre të dhënave, gjatë vitit 2020 janë ngrirë apo sekuestruar 19,182,157.00 € dhe 476,490.00 € pasuri janë konfiskuar.

Ndërkaq gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna në lidhje me realizimin e ndonjë aktiviteti të kësaj objekte.

Të dhënat e vetme të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial në lidhje me punën e PSh-së gjatë vitit 2020 ishin: Strategjia për Riorganizimin e PSRK-së; Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019; Raporti i PSh-së për gjashtë-mujorin e parë 2020, si dhe një Memorandum i Bashkëpunimit në mes të ATK-së dhe PSh-së.

7. REKOMANDIME

Duke bërë ndërlidhjen në mes të gjetjeve të këtij raporti dhe intencës për ngritje të efikasitetit të punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Prokurorit të Shtetit, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- o Të publikohen të gjitha të dhënat në lidhje me çdo aktivitet të realizuar të objektivave të përcaktuara nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.
- o Të publikohen raportet në fund të çdo viti me objektivat e arritura të vendosura në Planet e Punës për vitet përkatëse.
- o Planifikimi i realizimit të planeve të punës të bëhet përmes aktiviteteve sa më të matshme dhe të arritshme.
- o Planifikimi i objektivave të Planit të Punës së PSh-së të bëhet përmes aktiviteteve dhe mekanizmave me afate kohore të përmbylljes.
- o Të krijohen grupe punuese brenda KPK-së dhe PSh-së që të monitorohet realizimi i këtyre objektivave.
- o Niveli i realizimit të këtyre objektivave të monitorohet brenda periudhës tre apo gjashtë-mujore brenda vitit.
- o Të publikohen të gjitha raportet dhe aktet e miratuara nga ana e Këshillit, dhe jo vetëm të dhënat për miratimin/përfundimin e tyre.

BURIMET

- Këshilli Prokurorial i Kosovës, Plani i Punës së vitit 2020
(<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/PLANI%20I%20PUN%C3%8BS%20KPK%202020%20-%20SHQIP.pdf>).
- Prokurori i Shtetit, Plani i Punës së vitit 2020
(<https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSh/Plane%20te%20Punes/PLANI%20I%20PUN%C3%8BS%20I%20PROKURORIT%20T%C3%8B%20SHTETIT%20-%202020.pdf>
- Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
(<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>)
- Ligji nr. 06/ L-056 për Këshillin Prokurorial (<https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2709>)
- Intervista e mbajtur me zyrtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës me 24 shkurt 2021 në lidhje me sfidat e përmbushjes së këtyre objektivave.